

Shkrimet  
nuk duhet të  
jenë më të  
gjata se  
800 fjalë

## Analiza & Komente

# Rikthim pa adresë!



Albion Sherifi

**Zgjidhjet që mund të bëhen në këtë aspekt nuk janë të lehta e aq më pak pa koordinim ndërinstytucional. Për të arritur një standard minimal në trajtimin e**

Shoqëria jonë po rrëshqet ngadalë në një "popullatë lëvizëse" brenda trupit ekonomik evropian me shpresën për të gjetur një shtegdalje nga pamundësia ngufatëse e realizimit të aspiratave të tyre ekonomike e shoqërore. Kjo natyrshëm vjen si pasojë e zotërimit të një klime të pafavorshme institucionale për t'i përmbushur pritshmëritë dhe kërkesat qytetare. Arsyet e largimit nga vendi janë shumëdimensionale, qofshin ato arsye ekonomike, shëndetësore - për shërim ngase ka mungesa të infrastrukturës shëndetësore adekuate për trajtimin e sëmundjeve të caktuara, për shkak pakënaqësive politike dhe humbjes së besimit në institucioneve. Nuk do mend që një fenomen i tillë ka hapur një arkë thesari për kontrabandën, të cilët duke e zbrazur vendin kanë mbushur xhepat e tyre. Ata që largohen nuk pyesin më për ligjet që sanksionojnë migrimin dhe as për lidhjen emocionale me tokën dhe vendin ku u rritën, ata mësojnë individualisht apo familjarisht përmes rrugëve sa më të shpejta, e në shumicën e rasteve joligjore, të kapërcejnë vendnumërimin drejt vendeve që ofrojnë më shumë mundësi për perspektivën e tyre dhe familjeve të tyre për një punë më të pagueshme dhe një standard më të lartë mirëqenie. E gjithë kjo përfundon kur nuk ar-

Sallonet e së Martes janë një rishte javore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D) Sallonit ka format gjysmeformal sipas rregullës "Chatham House" dhe pa prani të medieeve. Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analiste, politikanë e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus rreth temat e përzier-hura. Fjala e hapjes postohet në kanalën e salloneve në "YouTube". Secili Salon përcillet me editorial që publikohet në "Zëri" të martën e ardhshme dhe në faqen elektronike të D4D-se. *Endri Haxhiu*

shtetërore. Natyrshëm edhe roli i shtetit është evident në trajtimin e këtij fenomeni, ndonëse jo me përkushtimin e merituar. Nëse e zbresim këtë kompetencë nga niveli qendror në atë lokal vërejmë se në organet e qeverisjes lokale ekzistojnë zyre për të riadhesuarit, porse që kanë rol kryesisht teknik e të varfër në kuptimin e ndihmës së familjeve apo personave të rikthyer. Mungon një mirëkoordinim në mes kompetencave dhe rolit të zyrave përkatëse nga niveli qendror në atë lokal. Gjithashtu edhe menaxhimi me financat e fondit për të riadhesuarit është në vartësi të kompetencës qendrore e që praktikisht zyrat lokale përkatëse janë të limituar në adresimin dhe në ndihmën e personave të rikthyer. E gjithë kjo pasqyrë funksionimi qeveritar për këtë çështje është e mjegullt dhe me shumë mbivendosje rolesh që në instancë të fundit lë pa mbështetjen e duhur personat e rikthyer. Theksi natyrisht bie te mungesa e një përkushtimi, serioziteti për t'i adresuar drejt dhe në koordinim të plotë me të gjithë akterët qeveritarë qendrorë dhe lokalë të kësaj teme. Megjithatë ka një sinjal pozitiv në horizont kur kemi parasysh investimin ndërkombëtar për rregullimin e kësaj çështjeje edhe në nivel ligjor e praktik.



## te rirormuoniet roli i zyrove lokale mbi këtë çështje, duke i dhënë kompetencë të shtuar menaxheriale.

bisedat mes njerezve rare lehte mund të konstruktivitet ideja se kemi të bëjmë me rikthim të "kampeve të përqendrimit" në formën më brutale, keqtrajtimin dhe lënies së njerzores mënjanë. Në shekullin e lëvizjes së lirë dhe të paqes së qëndrueshme ekzistenca e kampeve të tilla është sinjal se laku i izolimit po ia zë frymën një shoqërie. Para se gjithash, këtë fenomen duhet parë në disa prizma, në atë politik, ekonomik, social e kulturor. Në pikëpamje politike ekziston mendimi se një fenomen i tillë është nxitur dhe është mbështetur edhe nga vende jomiqësore me shtetin tonë për të krijuar opinionin e një vendi të paperspektivë dhe të pabanueshëm me kapacitete shtetërore që i ofrohen qytetarëve të saj. Në këtë kuadër duhet theksuar pritshmëritë e mëdha qytetare për një reformë ekonomike dhe hapje të vendeve të reja të punës, të cilat deri më tash më tepër se një titull medial dhe fjalë e thënë kanë rezultuar me realizim të pamjaftueshëm të këtij synimi. Në pikëpamjen sociale e kulturore, në një botë që zhvillohet përmes qarkullimit të idesë dhe lëvizjes së lirë që ka në thelb të saj ka lirinë individuale është fatale të imagjinohet një vend i izoluar, një shoqëri e izoluar nga rrjedha e zhvillimit botëror e që lëvizja e tyre kufizohet brenda kufijve territorialë e pak më gjerë ballkanik. Andaj një kurs i moderuar politik e shoqëror për trajtimin e shpejtë me zgjidhje konkrete për këtë fenomen është më se i domosdoshëm.

Në këtë pikë kemi shoqërinë të ndarë në dy grupe të mëdha: ata që largohen nga vendi dhe të rikthyerit. Për këta të fundit është investuar pak në infrastrukturën ligjore dhe të dokumenteve që rregullojnë këtë çështje, përjashtojtë strategjitë dhe dokumentet e tjera që deri diku riciklojnë këtë fenomen dhe trajtimin e saj. Kryesisht sponsorët më të mëdhenj të kësaj kauze për trajtimin të dinjitetshëm dhe më me shanse për të rikthyerit apo të riatdhesuarit janë mekanizmat joqeveritarë të cilët kanë avokuar vazhdimisht për këtë çështje në instance

<http://www.zeri.info>

**/opinione**

 like >  
[facebook.com/gazetazeri](https://facebook.com/gazetazeri)

 follow >  
[twitter.com/gazeta\\_zeri](https://twitter.com/gazeta_zeri)

kategorie shoqërore duhet të rishikohet dhe të riformulohet roli i zyrove lokale mbi këtë çështje, duke i dhënë kompetencë të shtuar menaxheriale. Gjithashtu, fuqizimi i sektorit privat përmes politikave të punësimit dhe të hapjes së bizneseve të reja është jetike në dhënien e zgjidhjes për mbështetjen materiale të të rikthyerve, por edhe më shumë në krijimin e kushteve që motivojnë njerzëzit të qëndrojnë. Institucionet shtetërore duhet të bëjnë më shumë në luftën ndaj kontrabandës dhe trafikimit të qenieve njerzore duke vendosur njëherë e mirë sundimin e ligjit në themel të funksionimit të shoqërisë.

Tejet e rëndësishme në këtë pikëpamje është edhe ndërmarra e një reforme në arsim për të rikualifikuar kërkesat për fuqinë punëtore dhe nivelin e arsimit në shoqërinë tonë, paçka nuk duhet lënë mënjanë edhe tendencën për fuqizimin e institucioneve të kujdesit social për të trajtuar dhe për të ndihmuar me zgjidhje praktike këtë kategori shoqërore, veçanërisht kur kemi një numër të madh të rikthyerve fëmijë. Komplexiteti i trajtimit adekuat të këtij fenomeni ka reduktuar vullnetin institucional për të ofruar zgjidhje praktike e lehtësim për të rikthyerit. Përpjekja e gjithë aparatit shtetëror dhe joqeveritar për të sendërtuar një shoqëri funksionale edhe në këtë pikëpamje është e domosdoshme dhe e pashmangshme në kuptimin afatgjatë. Të rikthyerit duhet të kenë adresën e qartë dhe shtetin kujdestar për të trajtuar kërkesat e tyre, si dhe për të ofruar ndihmën e nevojshme për të rimarrë në dorë mirëqenien e tyre. E gjitha mund të realizohet me seriozitet dhe koordinim gjithëpërfshirës në mes akterëve qeveritarë dhe joqeveritarë për të bërë më të jetueshëm dhe më me mundësi vendin për të gjithë të rikthyerit. Është koha që ky fenomen të mos mbetet vetëm titull medial dhe thesar financiar për kontrabanduesit, por mbrojtje e mirëqenie të ofruar nga institucionet përkatëse.



> Në këtë hapësirë: "Zëri" boton opinione, analiza, vështrime, qasje, reagime dhe letra të lexuesve. Shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 800 fjalë

> Redaksia mban të drejtën e shkurtimeve të materialeve të kësaj rubrike, apo edhe të mosbotimit të tyre, në rast se shkrimet për këtë rubrikë janë joprofesionale dhe joetike. Redaksia nuk qëndron prapa opinioneve që botohen në këto faqe.